



KONKURS

Shoqata **Down Syndrome Kosova** është organizatë jo qeveritare, e themeluar në vitin 2007 nga prindërit e personave me sindromën Down. Misioni i shoqatës është promovimi, respektimi dhe mbrojtja e të drejtave të personave me sindromën Down në Kosovë, dhe familjareve të tyre.

Down Syndrome Kosova shpall të hapur thirrjen për aplikim për poziten:

Menaxher/e Financiar/e

Detyrat dhe Përgjegjësitë Kryesore

- Organizon, drejton dhe mbikëqyrë të gjitha funksionet e menaxhimit financiar brenda organizatës;
- Përpilon buxhetin vjetor, analizon, raporton dhe jep këshilla në çështjet financiare të organizatës.
- Përpilon buxhetin në projekte, raporton tek donatorët e huaj dhe vendor.
- Kryen menaxhimin e kontabilitetit financiar të organizatës, monitorimin dhe raportimin ditorë e mujor brenda afateve të caktuara nga donatorët dhe nga vet organizata.
- Përgadit deklaratat mujore dhe vjetore për pagesat e tatimeve të Administratës Tatimore të Kosovës.
- Përgadit pasqyrat e të ardhurave dhe shpenzimeve.
- Menaxhon procesin e faturimit të produkteve të DSK-së.
- Përgjegjës për programin financiar të organizatës.

Kualifikimi dhe eksperiencia

- Diplomë të studimeve themelore në fushën e Ekonomisë (preferohet të ketë mbaruar studimet Master ose të jetë në përfundim të tyre).
- Përvojë punë së paku 3 vite, e dëshiruar përvojë pune në organizata jo qeveritare.
- Të ketë njohuri për programin financiar
- E obligueshme të ketë njohuri të shkëlqyeshme të gjuhës Angleze dhe aftësi për tu shprehur si në të folur ashtu edhe në të shkruar.
- E dëshirueshme certifikatë nga SCAAK, apo të ngjashme;
- Të ketë përvojë pune në ekip.

- Të jetë fleksibil

Lokaconi:

- Prishtinë

Si të aplikoni ?

- Të gjithë të interesuarit duhet të dërgojnë:
- CV të përditësuar
- Dëshmi për përgaditjen shkollore dhe profesionale
- Letër Motivuese
- Dëshmi për përvojën e punës.
- Subjekti: Aplikim –Menaxher/e Financiar/e– DSK në e-mail adresën: info@downsyndromekosova.org

Afati i fundit për aplikim:

- Jo më larg se me datë **07 Shkurt 2020 ora 16:00**
- Aplikacionet e pa kompletuara nuk do të merren parasysh.
- Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të kontaktohen dhe ftohen për fazën e ardhshme të rekrutimit.